

VARRIMI NË JAVËN E PASHKES

SHGRBESA NË SHTEPINË E TË VDEKURIT

Qe ditën e Pashkes gjer te Dielen e Shen Thomájt, këndimet ne Sherbesat Funerale jane më teper te Pashkes se te Varrimit. Ne shtëpi, Prifti e ve Petrahilin, temjanís, dhe bekón:

DHJAKU: Bekó, o Atë.

PRIFTI: I bekuar është Perendia ynë, gjithënjë, taní e perherë dhe në jetët e jëtëve.

KORI: Amín.

Pastáj Prifti këndón tri here Troparin e Pashkes:

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jetën u dhurój, të gjithë të varrósurve (3 here).

Pastáj Kori e këndón Troparin e Pashkes gjashtë here me Vargjet pasónjese, te cilat i thote Prifti perpara Troparit ne këtë formë:

PRIFTI: Le të ngrihet Perendia, dhe le të përdahen armíqt' e tij, dhe le të ikin prej faqes së tij atá, që i kanë merí.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jetën u dhurój, të gjithë të varrósurve.

PRIFTI: Sikunder humbét tymi, do të humbasin; sikunder shkrin qiriu përpara zjarrit.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jetën u dhurój, të gjithë të varrósurve.

PRIFTI: Ashtú do të humbasin mekateret prej faqes së Perendisë, dhe të drejtët do të defrejnc.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jetën u dhurój, të gjithë të varrósurve.

PRIFTI: Kjo është dita që bëri Zoti; le të ngazellóhemi, dhe le të defrejme n' atë.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jetën u dhurój, të gjithë të varrósurve.

PRIFTI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jetën u dhurój, të gjithë të varrósurve.

PRIFTI: Taní e perherë dhe në jetët e jëtëve. Amín.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vde-

kje vdekjen dyke shkelur, edhe jeten u dhurój, te gjithë te varrósurve.

Pastáj Prifti e thote Troparin e Pashkes nje here:

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jeten u dhurój, te gjithë te varrósurve.

Pastáj thuhet Litanja e Prehjes:

DHJAKU: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe per prehjen e sherbetorit te Perendise te jetenderruar (*aksh*), dhe qe ti falen te gjitha mekatat e dáshura dhe te padáshura.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Qe ta vendose Zoti Perendí shpirtin e tij atjé, ku prehen te drejtet, edhe ta vleresonje per Mbretérin' e qejve, Krishtit, Perendise dhe Mbretit tone te pavdekur, le ti lypim.

KORI: Fal-i, o Zot.

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Perendí i shpírteve dhe i gjithë trúpeve, qe shkele vdekjen, dhe dermove Djallin, dhe i dhurove botes jeten; ti, o Zot, preh-e shpirtin e sherbetorit te jetenderruar (*aksh*) ne vendin e drites, ne vendin e lendines, ne vendin e flladitjes, atjé, ku s' ka as dhembje as helme as pshe-

retím. Te gjitha mekatat, qe ka bere me fjale a me mendje, fal-i si Perendí i mire dhe njeridashes; se s' ka njerí, qe te rronje, dhe te mos bjere ne mekata; se ti je i vétemi i pamekatme; se drejtësia jote eshte drejtési per jete, dhe fjala jote esht e verteta.

Se ti je ngjallja, jeta dhe prehja e sherbetorit te jetenderruar (*aksh*), o Krisht, o Perendia yne, dhe ty te dergojme lavdí, bashke me Atin e panismë dhe me Shpirtin e treshenjtc dhe te mire dhe jeteberes, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia yne, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (3 here). Bekó, o Ate.

Pastáj Prifti thote Troparin e Pashkes tri here pa ze:

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jeten u dhurój, te gjithë te varrósurve (3 here).

Dhe menjehere Prifti ben Perleshimin:

PRIFTI: Krishti, Perendia yne i vertete, qe u-ngjall se vdékuresh, me nermjetimet e Shen Marise; te Shen Apostujve te lavderuar dhe emer-shkelqyer; te Shen Aterve tane oshenare dhe hyjprures; dhe te gjithë Shenjtóreve; e vendoste shpirtin e sherbetorit te jetenderruar (*aksh*) ne tendat e te Dréjteve; e prehte ne gjirin e Abraha-

mit; e nmerofte bashke me Shenjtoret; edhe né na meshirofte, dhe na shpetofte si i mire dhe nje-ridashes.

KORI: Amín.

PRIFTI: I perjetshim kujtimi yt, o vellá i yne i lumur dhe i perkujtuar (3 here).

KORI: I perjetshim kujtimi (3 here).

Pastáj Prifti thote tri here pa ze Troparin e Pashkes:

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jeten u dhurój, te gjithë te varrósurve (3 here).

Pastáj e ngrene lipsanin, dhe e shpien ne Kiske, dyke kenduar Troparin e Pashkes, ose Kanunin e Pashkes.

SHGRBESA FUNERALE NG KISHË

Passi shpíret lipsani ne Kiske, Prifti temjanis, dhe Kori kendón Zbratesoret e Pashkes ne Tingellin I:

I: Dit' e Ngjalljes sot na ndriti, ngazellóhuni pra, Pashka e Zotit Pashka; se ja prej vdekjes ne gezím, dhe prej dheut lart ne qell, na shpuri me kenge múndese Zoti Krisht, Shpetimtari i shpír-teve.

III: Eni pini uje krejt te re, qe s' e nxori prej shkembít, shkopi çuditerisht, po qe burón si reké, nga varri i Zotit Jesú Krisht, i cili na fal sherím.

IV: Nga fron' i qellit o Profét, perendifoles Abakúm, eja sot me né dhe tregona, driten edhe Engjellin, i cili sheshit lajmerón: Sot i ka ardhur

botes shpetimi, se Jesú Krishti u-ngjall, si Perendí dhe Zot.

V: Mengoni me nate dhe eni, dhe le ti shpiem kendime, si myrre Zotit ne varret, dhe do ta shikojme Krishtin, díellin qe u dhurón, jeten dhe paqen te gjithëve.

VI: Kur zbrate gjer ne funt te dheut ne Ferr, dhe dermove gjithë llozet e burgut, çlirove skllvet e jéteve, edhe pas tri ditsh prej balenes si Jonáj, dolle jashte nga varri.

VII: Tre Djemat midis flages i mproj me shi, dhe vete u-be njerí, dhe pesój si né, dhe me pesimin shpetimtár, na stolisi me jeten qe nuke vdes, i vétemi Perendí i bekuar, i Aterve lavdí me ty.

VIII: Dit' e sotme esht e shenuar e shenjtc, e para dit' e javes, si mbretereshe dhe zonje, nje kremtím qe s' ka shoq, dhe nje panaír i panaíreve. Sot pra e bekojme, per jete Jesú Krishtin.

IX: Nje Engjell i therriste, hirplotes pa pushuar: Gezohu Virgjereshe, dhe prape te thom Gezohu, se Biri yt u-ngjall qe prej varrit i tridicim.

Ndriçohu ndriçohu, qytét i ri Jerusalém, se lavdia e Zotit, permi ty ka lindur sot. Valle kecé, dhe gezohu Sión, ti o Marí, Nen' e Perendise, defré per ngjalljen e Birit tent.

Pastáj thuhet Shkurtorja dhe Shtepia e Prehjes ne T. T. IV:

Me gjithë Shenjtoret, o Zoti Krisht e preh, shpirtin e besnikut tent, atjé ku s' ka as dhembje,

as helme, as psheretím, po vetem jete te pambuar.

Ti i vetem o Zot i pavdekur je, ti qe bere natyren dhe njërezit; dhe sikunder prej dheut krijohemi, gjithashtú nene dhé do te kthéhem, sikunder urdherove ti o Zot, dyke thene: Dhé ke qene dhe ne dhene po kthehesh, se atjé do te shkojme né njërezit, dyke thirrur me lot e me vaj qe te gjithë: Alilluja.

Pastáj thuhet Litania e Prehjes:

DHJAKU: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe per prehjen e sherbetorit te Perendise te jetenderruar (*aksh*), dhe qe ti falen te gjitha mekatat e dáshura dhe te pádashura.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Qe ta vendose Zoti Perendí shpirtin e tij atjé, ku prehen te drejtet, edhe ta vleresonje per Mbretérin' e qejve, Krishtit, Perendise dhe Mbretit tone te pavdekur, le ti lypim.

KORI: Fal-i, o Zot.

PRIFTI: Se ti je ngjallja, jeta dhe prehja e sherbetorit te jetenderruar (*aksh*), o Krisht, o Perendia yne, dhe ty te dergojme lavdí, bashke me Atin e panisme dhe me Shpirtin e tereshenje dhe

te mire dhe jetebes, taní e perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín. Sa u-pagezuat me Zotin Krisht, u-veshte me Zotin Krisht. Alilluja (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jeteve. Amín. U-veshte me Zotin Krisht. Alilluja.

Sa u-pagezuat me Zotin Krisht, u-veshte me Zotin Krisht. Alilluja.

Pastáj thuhet Apostulli dhe Ungjilli i Pashkes:

DHJAKU: Le te veme re.

KENDONJESI: Kjo eshte dita, qe beri Zoti; le te ngazellohemi, dhe le te defrejme n' até.

DHJAKU: Urtesí.

KENDONJESI: Kendimi prej Akteve te Apostujve.

DHJAKU: Le te veme re.

KENDONJESI: Ne shkresen e pare, o Theofil, kam folur per veprat, qe beri Jesúj, dhe per mesimet, qe dha gjer ditën, qe fluturoj ne qell, pasi u la Apostujve, qe pati zgjedhur, porrosira me anen e Shpirtit Shenjt. Perpara ketyre u-fanés i gjalle pas pesímeve me shume shenja, dyke u-dukur perpara atyre per dyzét dite dhe dyke u folur mi Mbretérin' e Perendise. Dhe nje dite, qe ishin mbledhur, i porrositi te mos largohen nga Jerusalemi, po ta presin zotimin e Atit, per te cilin ju kam folur. Se Joani pagezój me uje, po ju do te

pagezoheni me Shpirtin Shenjt pas pake ditesh qe sot. Pra, kur ishin mbledhur, e pyesnin, dhe i thoshin: "O Zot, a do ta ristorosh Mbreterin' e Israelit ketë here?" Dhe aý u tha: "Nuk eshte puna juaj te dini kohet e motet, te cilat i ka ne dorë Ati. Po do te merrni fuqí, kur te vinje mi ju Shpirti Shenjt. Dhe do te deshmoni per mua ne Jerusalém dhe ne tere Judene dhe Samarine dhe gjer ne fund te dheut."

KORI: Alilluja, alilluja, alilluja.

DHJAKU: Urtesí, o te drejte. Le ta degjojme Ungjillin e Shenjte.

PRIFTI: Paqe te gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tende.

PRIFTI: Kendimi prej Ungjillit te Shenjte pas Joanit.

DHJAKU: Le te veme re.

PRIFTI: Ne krye ishte Fjala, dhe Fjala ishte me Perendine, dhe Fjala ishte Perendí. Ky ishte ne krye me Perendine, dhe te gjitha u-bene me anen e tij, dhe pa até nuk u-be asnjé kriese. Aý kishte jete; dhe jeta ishte drita e njéresve. Ishte nje njerí, i derguar nga Perendia, i cili quhej Joán. Ky ardhi qe te deshmonte per driten, qe te besonin te gjithë me anen e tij. Aý nuk ishte Drita, po vetem deshmonte per Driten, per Driten e vertete, qe i ndrit te gjithë njérezit, qe vijne ne bote. Ardhi ne bote, dhe bota u-be me anen e tij, po bota nuk e njohu. Ardhi ne njérezit e tij, po njérezit

e tij nuk e pritne. Po atyre, te cilet e pritne, dhe besuan me emrin e tij, u dha fuqí te behen bij te Perendise, te cilet nuke lintne nga gjaku e nga trupi prinderór po nga Perendia vete. Edhe Fjala u-misherua, dhe banój ne mes tone, dhe e pamë lavdín' e tij, si lavdí te Birit te vetemlindur te Perendise, plot me hir e me te vertete. Joani desh-mój per até, dhe thirri, dyke thene: "Aý, qe vjen pas meje, eshte mé i math se une, se ishte perpara meje." Dhe nga plotesi' e tij kemi marre hir per hir te gjithë né. Se ligja u-dha prej Moisiut, po hiri dhe e verteta arthne prej Jesú Krishtit.

KORI: Lavdí me ty, o Zot, lavdí me ty.

KENDONJCSI: Passi pame Ngjalljen e Krishtit, le ti fálemi Zotit te Shenjte Jesú, te vétemit te pamekatme. Kryqit tent po i fálemi, o Krisht, edhe Ngjalljen tende te shenjte po hymnojme dhe lavderojme, se ti je Perendia yne, veç teje nuke njohim tjater, emrin tent po emerojme. Se ja, me anen e Kryqit ardhi gezimi ne tere boten, se dyke duruar Kryqin, e dermove vdekjen me vdekje.

Pastáj kendohet Dergimesorja e Pashkes:

T. II: Si fjete si njerí me trup, o Mbreti yne Zoti Krisht, u-ngjalle i tridicim, ngrite Adamin nga varri, dhe e dermove vdekjen. Pashka e papri-shjes, shpetimi i botes.

Pastáj kendohen Bekimtoret Funerale me T. T. I:

I bekuar je, o Zot, mesome te drejtat e tua.

Shoqëria e Shenjtórove, gjeti burimin e jetes, dhe deren e Parajsës; pra do ta gjenj, edhe unë udhen me pendimin; un' i mjeri jam del' e humbur pa barí; thirr-me pranë teje, shpëtoje ti o Zot.

I bekuar je, o Zot, mësonje të drejtat e tua.

O Krijetar, ti më bere ti më dhé, shembellsinë tënde të perëndishme, dhe kur shkela porrosinë verberisht, më vertite në dhënë ku më more, be-më sipas korës sate perserí, kthema prapë bukurín' e móçime.

I bekuar je, o Zot, mësonje të drejtat e tua.

Një korë jam, e lavdisë pa tregím, ndónese kam njolla prej fajesh; kij dhembje pra, si një Atë për një bir, dhe spastroje pas meshirës sate; dhe n' atdhén' e dashur perserí më kthe, në Parajsën qytetar më bej.

I bekuar je, o Zot, mësonje të drejtat e tua.

O Perendí, preh-e sherbetorin tent, dhe vendose në Parajsën e bekuar, ku po defrén shoqëria e Shenjtórove, dhe të drejtet po shkelqejnë si yj të ndriçim; pra mekatat më meshirë ti ia ndje, edhe preh-e sherbetorin tent.

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt.

Një trishkelqím, një Triní një Perendí, adhurojme beserisht e thomi: I shenjte je, i panismi At e Bir, edhe Shpirti tereshénjt i perëndishme; ti pra na ndriçó, né që po të lútemi, dhe nga zjarri i Sketerres na shpëtó.

Taní e perhere dhe në jetet e jéteve. Amín.

O Shen Marí, ti që linde Perëndinë, Jesunë Shpëtimtarin, që i dha shpëtimin botës, edhe gjindjes njërezore. Parajsën falna o Hyjlíndëse, Virgjëreshë dhe Nen' e bekuar.

Alilluja, alilluja, alilluja, lavdí më ty, o Zot (3 here).

Pastáj thuhet Litanía e Prehjes:

DHJAKU: Meshirona, o Perendí, pas meshirës sate se madhe, të lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe për prehjen e sherbetorit të Perëndisë të jetenderruar (*aksh*), dhe që ti falen të gjitha mekatat e dáshura dhe të padáshura.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Që ta vendosë Zoti Perendí shpirtin e tij atjé, ku prehen të drejtet, edhe ta vlerësonjë për Mbretërin' e qejve, Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë të pavdekur, le ti lypim.

KORI: Fal-i, o Zot.

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Perendí i shpírteve dhe i gjithë trúpeve, që shkele vdekjen, dhe dermove Djallin, dhe i dhurove botës jetën; ti, o Zot, preh-e shpirtin e sherbetorit të jetenderruar (*aksh*) në vendin e drites, në vendin e lendinës, në vendin e flladitjes, atjé, ku s' ka as dhembje as helme as pshe-

retím. Te gjitha mekatat, që ka bërë me fjale a me mendje, fal-i si Perendí i mirë dhe njeridashës; se s' ka njerí, që të rronjë, dhe të mos bjere në mekata; se ti je i vétëmi i pamekatme; se drejtësia jote është drejtësi për jetë, dhe fjala jote është e verteta.

Se ti je ngjallja, jeta dhe prehja e shërbëtorit të jetënderruar (*aksh*), o Krisht, o Perendia ynë, dhe ty të dergojmë lavdí, bashkë me Atin e panismë dhe me Shpirtin e tërëshenjtë dhe të mirë dhe jetëbërës, taní e përherë dhe në jetet e jeteve.

KORI: Amín.

Pastáj kendohen Vargëzimet e Pashkes në Tíngëllin Terthór I:

VARK: Le të ngrihet Perendia, dhe le të përdahen armíqt' e tij, dhe le të ikin prej faqes së tij atá, që i kanë merí.

Pashka e bekuar na ndriti dhe na shkelqeu sot; Pashk' e shenjtë Pashk' e re; Pashka plot mistër; Pashka e përndërcime; Pashka me Krishtin çlirimtár; Pashk' e ndrícime, Pashk' e madhe, Pashka për besník; Pashka që çeli çdo derë të Parajsës për neve; Pashk' e Krishtit që bekón çdo besník.

VARK: Sikunder humbét tymi, do të humbasin; sikunder shkrin qiriu përpara zjarrit.

Ejani prej pamjes o gra mirelajmëronjëse, edhe Siones thójini, lajmen me gezím prej nesh po mesójeni; luaj dhe këcé, dhe gezohu o Jerusa-

lém, se Mbretin tonë Jesú, e pé të ngjallet prej së vdekuresh, me kurorë prej një dhéntëri.

VARK: Ashtú do të humbasin mekataret prej faqes së Perendisë, dhe të drejtet do të defrejne.

Grate myrepruresë arthnë pa u-gedhire, dhe qëndruan pranë varrit të Shpëtimtarit, gjetnë Çngjellin i cili rrinte mi gur atjé, dhe aý u-drejtuat mi ató dhe kështú u tha: Si kerkoni të gjallin me të vdekurit? Si vajtoni të prishur të paprishurin? Shkoni lajmen shpëjërni Apostujve të tij.

VARK: Kjo është dita, që bëri Zoti; le të ngazellóhemi, dhe le të defrejme n' até.

Pashka që na çel; Pashka e Zotit Pashka; Pashka e nderuar na shkelqeu sot mi dhé; Pashka me gezím, pra eni të përsëndóshemi; o Pashka që ndjek helmin! Se sot prej varrit pas tri ditësh, si prej nuserores ndriti Jesú, dhe grate i gezój dyke u thënë: Leçituni Apostujve.

LAVDI E TANI: Ardhi dit' e shenjt' e Ngjalljes, le të ndrícóhemi prej panairit, edhe eni të përsëndóshemi; çpallim sot vllazëri, me sa na kanë merí, le ti ndejmë të gjitha ditën e Ngjalljes, dhe le të thërresim sot: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jetën u dhurój, të gjithë të varrósurve (3 *here*).

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia ynë, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín. Mëshiró, o Zot (3 *here*). Bekó, o Atë.

Pastáj Prifti thote Troparin e Pashkes tri here pa ze:

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jeten u dhuró, te gjithë te varrósurve (3 here).

Dhe menjehere Prifti ben Perleshimin:

PRIFTI: Krishti, Perendia yne i vertete, qe u-ngjall se vdekuresh, me nermjetimet e Shen Marise; te Shen Apostujve te lavdruar dhe emer-shkelqyer; te Shen Aterve tane oshenare dhe hyj-prures; dhe te gjithë Shenjtóreve; e vendoste shpirtin e sherbetorit te jetenderruar (aksh) ne tendat e te Dréjteve; e prehte ne gjirin e Abrahemit; e nemofofte bashke me Shenjtoret; edhe né na meshirofte, dhe na shpetofte si i mire dhe nje-ridashes.

KORI: Amín.

PRIFTI: I perjetshim kujtimi yt, o vellá i yne i lumur dhe i perkujtuar (3 here).

KORI: I perjetshim kujtimi (3 here).

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jeten u dhuró, te gjithë te varrósurve (3 here).

Pastáj e ngrene lipsanin, dhe e shpien ne varret, dyke kenduar Troparin e Pashkes.

SHERBESA FUNERALE NE VARR

Kur e shpien lipsanin ne varr Javen e Pashkes, Prifti temjanis, dhe bekón:

PRIFTI: I bekuar eshte Perendia yne, gjithë-

një, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

Pastáj Prifti kendón tri here Troparin e Pashkes:

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jeten u dhuró, te gjithë te varrósurve (3 here).

Pastáj thuhet Litanía e Prehjes:

DHJAKU: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe per prehjen e sherbetorit te Perendise te jetenderruar (aksh), dhe qe ti falen te gjitha mekatat e dáshura dhe te padáshura.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Qe ta vendose Zoti Perendí shpirtin e tij atjé, ku prehen te drejtet, edhe ta vleresonje per Mbretérin' e qejve, Krishtit, Perendise dhe Mbretit tone te pavdekur, le ti lypim.

KORI: Fal-i, o Zot.

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Perendí i shpírteve dhe i gjithë trúpeve, qe shkele vdekjen, dhe dermove Djallin, dhe i dhurove botës jeten; ti, o Zot, preh-e shpirtin e sherbetorit te jetenderruar (aksh) ne vendin e drites, ne vendin e lendines, ne vendin e fladitjes, atjé, ku s' ka as dhembje as helme as pshe-retím. Te gjitha mekatat, qe ka bere me fjale a

me mendje, fal-i si Perendí i mire dhe njeridashës; se s' ka njerí, qe te rronje, dhe te mos bjere ne mekata; se ti je i vétemi i pamekatme; se drejtësia jote është drejtésí per jete, dhe fjala jote është e verteta.

Se ti je ngjallja, jeta dhe prehja e shërbëtorit te jetënderruar (*aqsh*), o Krisht, o Perendia yne, dhe ty te dergojme lavdí, bashke me Atin e panis-me dhe me Shpirtin e tereshenjte dhe te mire jetëberës, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia yne, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (*3 here*). Bekó, o Ate.

PRIFTI: Krishti, Perendia yne i vertete, qe ungjall se vdékuresh, me nermjetimet e Shen Marise; te Shen Apostujve te lavderuar dhe emer-shkelqyer; te Shen Aterve tane oshenare dhe dhe hyjprures; dhe te gjithë Shenjtóreve; e vendoste shpirtin e shërbëtorit te jetënderruar (*aqsh*) ne tendat e te Dréjteve; e prehte ne gjirin e Abrahemit; e nmerofte bashke me Shenjtoret; edhe né na meshirofte, dhe na shpetofte si i mire dhe njeridashes.

KORI: Amín.

PRIFTI: I perjetshim kujtimi yt, o vellá i yne i lumur dhe i perkujtuar (*3 here*).

KORI: I perjetshim kujtimi (*3 here*).

Pastáj Prifti thote Troparin e Pashkes tri here pa ze:

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe jeten u dhurój, te gjithë te varrósurve (*3 here*).

Perpara se te vihet lipsani ne varr, Prifti merr me lopaten ca dhé, e heth mi lipsanin kryqthi, dhe thote:

PRIFTI: Zoti e ka dhene dhe plotésin' e tij, boten e tere dhe gjithë banoret e saj.

Pastáj Prifti derth mi lipsanin kryqthi vaj e vere, ose hi te Temjanices.

Pershpirte me Grure nuke behen Javen e Pashkes. Gjithashtú nuke behen Pershpirte ne te kremtet e shenú-ara, si Rushajet, Kershendellat, Motin e Ri, Ujet e Bekuar dhe te Dielen e Lúleve.